* - përgatitja e paraqitjes së masave të mbrojtjes në punë (studimi i mbrojtjes në punë), përgatitja e planeve për rregullimin e mjedisit të punës dhe veprimtarisë së koordinatorit I dhe koordinatorit II për mbrojtjen në punë----

- përgatitja e vlerësimit të rrezikut nga zjarri dhe plani i mbrojtjes nga zjarri
- përgatitja e paraqitjes së masave të mbrojtjes nga zjarri (studimi i mbrojtjes nga zjarri) dhe veprimtari të projektimit dhe mbikqyrjes në zonat e mbrojtura nga zjarri--------------------------------------------------------------------------------
- testimi i sistemeve të qëndrueshme për lajmërimin dhe fikjen e zjarrit--------

testimi i sistemeve për zbulimin dhe përqëndrimin e gazeve të ndezshme dhe shpërthyes------------------------------------------------------------------------

* - trajnim në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimet-----------------------

* - ekspertizë për mbrojtjen në punë dhe mbrojtjen nga zjarri--------------------

* - kryerja e veprimtarive profesionale në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit: përgatitja e vlerësimit të rrezikut/kërcënimit të popullsisë, të mirave kulturore dhe materiale, përgatitja e planeve të mbrojtjes dhe shpëtimit, përgatitja e planeve të mbrojtjes civile, planeve operacionale dhe të jashtme, trajnimi dhe përmirësimi në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, organizimi dhe performimi i ushtrimeve të mbrojtjes dhe shpëtimit-----------------------------------------------

* - përgatitja e vlerësimit dhe planit të mbrojtjes së sigurisë në porte dhe zonat operacionale të portit------------------------------------------------------------

* - përgatitja e vlerësimit dhe planit të mbrojtjes së sigurisë në anije---------------

* - testimi i sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, të pajisjeve ngritëse dhe ngarkuese në anije----------------------------------------------------------------------

* - aktivitete profesionale të mbrojtjes së mjedisit-----------------------------------------

* - aktivitete profesionale të mbrojtjes nga zhurmat-------------------------------------

* - aktivitete profesionale të mbrojtjes nga rrezatimi jonizues-----------------------

* - testimi i instalimeve elektrike, të mbrojtjes nga rrufeja, të tokëzimit dhe mbrojtje nga elektriciteti statik-------------------------------------------------------

* - testim dhe kqyrje – mbikqyrje teknike e pajisjeve elektrike në performacën kundërshpërthyese--------------------------------------------------------

* - kqyrje teknike dhe testimi i strehave dhe objekteve me dy qëllime-----------

* - testim i instalimeve të gazit dhe sahatëve të gazit---------------------------------

* - testim i aparatëve me ventilim dhe klimatizim, instalime për ngrohjen qendrore, instalime kanalizimesh, të grumbullimeve dhe gropave septike, dhe ndarësve të yndyrnave-----------------------------------------------------------

* - përgatitja e zgjidhjeve teknike për përdorimin racional të energjisë dhe mbrojtjes termike të ndërtesës, dhe matja e izolimit termik-----------------

* - kryerja e kontrolleve energjitike dhe certifikim energjitik i ndërtesave---------

* - testimi i makinerive dhe impianteve industrial-------------------------------------------

* - testimi dhe kontrolli i ashensorëve, shkallëve lëvizëse, pistave lëvizëse për transportin e njerëzve dhe platformave për transportin e invalidëve------------

* - këshillim teknik dhe shërbime këshillimore në fushën e industrisë, sigurisë publike dhe personale, mbrojtjes në punë, mbrojtjes nga zjarri,

Nr.:OU-4/16-1

mbrojtjes së mjedisit dhe organizimi i seminareve dhe kurseve për të punuar në këto fusha--------------------------------------------------------------------------

- veprimtari të aktiviteteve profesionale të mbrojtjes nga zhurmat: matja dhe parashikimi i nivelit të zhurmave në ambientet ku njerëzit punojnë dhe qëndrojnë, përgatitja e hartava të zhurmave dhe planeve të veprimit, përgatitja e vlerësimit të ndikimit të zhurmave në mjedis, matja e izolimit akustik, përgatitja e studimit për sanimin e zhurmave
- bllokim mekanik dhe elektronik audio dhe aparateve video me fuqi dalëse të sinjalit audio – kufizim i nivelit të zhurmave-------------------------

* - përgatitja e dokumentacionit teknik të makinerive, impianteve industrial dhe impianteve termoteknik-------------------------------------------------------------------

* - kryerja e instalimeve elektrike dhe instalimeve të ujit, gazit, ngrohjes, ventilimit, ftohjes dhe punë të tjera instalimi-------------------------

* - projektim i instalimeve elektrike dhe mekanike, dhe aparateve, pajisjeve, impianteve dhe sistemeve të sigurisë---------------------------------------

* - kryerja e kontrollit dhe testimi i instalimeve (gaz, karburant i lëngshëm dhe ujë), makinerive dhe aparateve me rrezik të shtuar, në fushën e pajisjeve të presionit--------------------------------------------------

* - kryerja e aktiviteteve të mirëmbajtjes, servisimit, rregullimit dhe kalibrimit të aksesorëve të sigurisë në pajisjet e presionit------------------------

* - përgatitja dhe prodhimi i shenjave të sigurisë------------------------------------------

* - ofrimi i këshillimit mbi pajisjet kompjuterike (hardware), përgatitja, këshillimi dhe sigurim i pajisjeve të programimit (software), përpunim i të dhënave, mirëmbajtja dhe rregullimi i sistemeve kompjuterike, si dhe aktivitete të tjera të lidhura me kompjuterët-----------------------------------

* - Web dizajn, reklama dhe propaganda në web, mirëmbajtja e faqeve web, veprimtari botimi në faqet web (krijimi dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit të aplikacioneve web, aplikacionet e rrjetit dhe të ngjashme)-------------------------------------------------------------------------------

* - veprimtari llogarie-kontabiliteti---------------------------------------------------

* - promovimi (reklama dhe propaganda)---------------------------------------------

* - aktivitete profesionale të rregullimit të ambientit--------------------------------

* - projektimi, ndërtimi, përdorimi dhe heqja e ndërtimeve-----------------------

* - mbikqyrje gjatë ndërtimit-------------------------------------------------------------

* - shitje dhe blerje malli----------------------------------------------------------------

* - realizimi i ndërmjetësimit tregtar në tregun vendas dhe të huaj---------------

* - përfaqësim i kompanive të huaja-----------------------------------------------------

* - veprimtari të monitorimit të cilësisë së ajrit-----------------------------------

* - veprimtari për monitorimin e emetimeve të ndotësve në ajër nga burimet e palëvizshme------------------------------------------------------------------------------

* - veprimtari të kontrollit të saktësisë të sistemit matës për vazhdimësinë e matjes së emetimeve të ndotësve në ajër nga burimet e palëvizshme--------

* - veprimtari për sigurimin e cilësisë së matjeve dhe të dhënave për cilësinë e ajrit--------------------------------------------------------------------------------

Nr.:OU-4/16-1

* - veprimtari për mbledhjen, kontrollin e rrjedhjeve, instalimin dhe mirëmbajtjen ose servisimin (servis) të aparateve dhe pajisjeve ftohëse dhe klimatizuese, pompat e nxehtësisë, sistemet e palëvizshme kundër zjarrit dhe aparate për fikjen e zjarrit që përmbajnë substanca të kontrolluara ose gazra serrë me fluor ose që varen prej tyre-----------------------------------------------------------

- veprimtari për mbledhjen, rinovimin, rikuperimin dhe shitjen e substancave të kontrolluara të rikuperueshme dhe gazrave serrë---------------------------
- veprimtari import/eksport dhe shitja e substancave të kontrolluara dhe/ose gazrave serrë me fluor, servisimi, rinovimi dhe rikuperimi i atyre substancave-----------------------------------------------------------------------

* - veprimtari e përpunimit tjetër të mbetjeve-------------------------------------------
* - veprimtari e rikuperimit të mbetjeve---------------------------------------------
* - veprimtari ndërmjetësimi për menaxhimin e mbetjeve----------------------------
* - veprimtari e transportimit, mbledhjes dhe menaxhimit të mbetjeve------------
* - veprimtari e tregtimit të mbetjeve-----------------------------------------------
* - menaxhim mbetjesh--------------------------------------------------------------
* - veprimtari testimi dhe analiza e mbetjeve----------------------------------------
* - certifikimi i instaluesve të sistemit fotovoltaik, sistemeve termike diellore, kaldajave të vogla dhe furrave me biomasë, dhe sistemeve të cekëta gjeotermike dhe pompave të nxehtësisë------------------------------
* - projektim teknik dhe këshillim---------------------------------------------------
* - testim teknik dhe analiza---------------------------------------------------------
* - prodhim i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre----------------------
* - përpunimi dhe veshja e metaleve-------------------------------------------------
* - përpunim metali me makineri-----------------------------------------------------
* - prodhim kushinetash, transmisionesh dhe elementëve të transmisionit dhe motorit
* - prodhim i pajisjeve për ngritje dhe mbajtje-----------------------------------------
* - rregullim i produkteve metalike, impianteve dhe pajisjeve elektrike-------------
* - instalimi i impanteve industriale dhe pajisjeve-------------------------------------

**Neni 6**

KAPITALI THEMELTAR:
Vlera totale e kapitalit themeltar të shoqërisë është 1. 167. 000, 00 kn (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë kuna).-----------------------------------------------------------------------
Kapitali themeltar është paguar plotësisht dhe është vendosur në shoqëri.----------------------------

**Neni 7**

KUOTA E BIZNESIT:
Në shoqëri ekzistojnë 24 (njëzet e katër) kuota biznesi dhe konkretisht: 21 (njëzet e një) kuota biznesi secila në shumën nominale të 1. 000, 00 kn (njëmijë kuna) dhe 3 (tre) kuota biznesi secila në shumën nominale të 382. 000, 00 kn (treqind e tetëdhjetë e dy mijë kuna).-----------------------
Ortaku i shoqërisë RADE PEHAR mori 7 (shtatë) kuota biznesi, secila në shumën nominale të 1.000, 00 kn (njëmijë kuna), të tilla nga numri rendor 1 (një) dhe mbyllet me numrin rendor 7

(shtatë), si dhe 1 (një) kuotë biznesi në shumën 382.000, 00 kn (treqind e tetëdhjetë e dy mijë kuna) në numrin rendor 22 (njëzet e dy).------------------------------------------------------------------
Ortaku i shoqërisë DENIS RADIĆ-LIMA mori 7 (shtatë) kuota biznesi, secila në shumën nominale të 1.000, 00 kn (njëmijë kuna), të tilla nga numri rendor 8 (tetë) dhe mbyllet me numrin rendor 14 (katërmbëdhjetë), si dhe 1 (një) kuotë biznesi në shumën 382.000, 00 kn(treqind e tetëdhjetë e dy mijë kuna) në numrin rendor 23 (njëzet e tre).----------------------------------------------
Ortaku i shoqërisë IVICA BELIĆ mori 7 (shtatë) kuota biznesi, secila në shumën nominale të 1.000, 00 kn (njëmijë kuna), të tilla nga numri rendor 15 (pesëmbëdhjetë) dhe mbyllet me numrin rendor 21 (njëzet e një), si dhe 1 (një) kuotë biznesi në shumën 382.000, 00 kn(treqind e tetëdhjetë e dy mijë kuna) në numrin rendor 24 (njëzet e katër).----------------------------------------
Secila kuotë biznesi jep të drejtën e një vote në Asamble.-----------------------------------------------
Shuma nominale e të gjithë kuotave të biznesit është e njëjtë me shumën e kapitalit themeltar të shoqërisë.---------------------------------------------------------------------------------------------------

**Neni 8**

MENAXHIMI I KUOTAVE TË BIZNESIT
Ortaku i shoqërisë mund të ketë më shumë se një kuotë biznesi.-----------------------------------------
Kuotat e biznesit mund të transferohen dhe të trashëgohen.-----------------------------------------------
Nëse ortaku i shoqërisë përfiton kuota të reja biznesi, secila kuotë e atij ortaku mbahet në mënyrë individuale.----------------------------------------------------------------------------------------------------
Për transferimin e kuotave të biznesit është e nevojshme të merret miratimi i Asamblesë.----------
Ortakët e shoqërisë dakordësojnë që kanë të drejtën e blerjes së kuotave të shoqërisë përpara transferimit të kuotave, në proporcion me kuotat e biznesit që kanë në momentin e transferimit.
Informacioni për qëllimin e transferimit duhet t'i jepet të gjithë ortakëve të shoqërisë përmes postës rekomande ose në adresën e tyre të e-mailit 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara lidhjes së kontratës mbi transferimin. Nëse ndonjë nga ortakët nuk e shfrytëzon të drejtën e tij, atëherë ortakët e tjerë kanë të drejtë në mënyrë proporcionale që të marrin kuota shtesë.

**Neni 9**

LIBRI I KUOTAVE TË BIZNESIT
Në raport me shoqërinë, ortaku i shoqërisë është vetëm ai që është regjistruar në Librin e kuotave të biznesit.-----------------------------------------------------------------------------------------------------
Bordi Drejtues ka detyrimin të mbajë Librin e kuotave të biznesit të shoqërisë.----------------------

**Neni 10**

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË:
Shoqëria është themeluar për një periudhë kohore të pacaktuar.-----------------------------------------

**Neni 11**

ORGANET E SHOQËRISË:
Shoqëria ka këto organe:----------------------------------------------------------------------------------------

**Neni 12**

BORDI DREJTUES:
Bordi Drejtues përbëhet nga një deri në tre administrator.------------------------------------------------

**Neni 13**

MBARËVAJTJA E PUNËVE:
Administratorët kryejnë/menaxhojnë punët me përgjegjësinë e tyre individuale. --------------------
Anëtarët e Bordit Drejtues- administratorët janë të autorizuar për të ndërmarrë veprime për mbarëvajtjen e punëve të shoqërisë, pa kufizime.----------------------------------------------------------------
AUTORITETI I ANËTARËVE TË BORDIT-----------------------------------------------------------------------
Administratorët përfaqësojnë individualisht dhe në mënyrë të pavarur.-------------------------------
Përfaqësim i pakufizuar.------------------------------------------------------------------------------------------
AUTORITETI NË PËRFAQËSIM--------------------------------------------------------------------------------
Administratorët përfaqësojnë shoqërinë individualisht dhe në mënyrë të pavarur.------------------
Administratorët përfaqësojnë shoqërinë pa kufizime.-------------------------------------------------------

**Neni 14**

VENDIMI PËR EMËRIMIN E BORDIT DREJTUES:
Vendimi për emërimin e Bordit Drejtues merret nga themeluesit-ortakët e shoqërisë.---------------

**Neni 15**

SHKARKIMI I BORDIT DREJTUES:
Ortakët e shoqërisë, me vendimin e tyre në çdo kohë mund të shkarkojnë anëtarët e Bordit Drejtues.-----------------------------------------------------------------------------------------------------------

**Neni 16**

ASAMBLEJA:
Asambleja e shoqërisë përbëhet nga ortakët e shoqërisë.----------------------------------------------
Asambleja merr vendime në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për shoqëritë tregtare" dhe në përputhje me këtë Marrëveshje.---------------------------------------------------------------------------------

**Neni 17**

NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN E SHOQËRISË:
Marrëveshja e Shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të ortakëve të shoqërisë.----------
Vendimi duhet të jetë dokument i përpiluar përpara noterit.-------------------------------------------------
Vendimi për ndryshimet nuk ka efekt ligjor deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar.--
Vendimi për ndryshimet merret me shumicën e të paktën tre të katërtave të votave.-----------------

**Neni 18**

ZMADHIMI I KAPITALI THEMELTAR:
Për zmadhimin e kapitalit themeltar është i nevojshëm vendimi i themeluesve mbi ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje.------------------------------------------------------------------------------------



Kapitali themeltar mund të zmadhohet:-------------------------------------------------------------------

- me pagim për marrjen e kuotave të reja biznesi ose me pagim për rritjen e kuotave ekzistuese të biznesit
- me vendosjen e rezervave të shoqërisë në kapitalin themeltar
- me vendosjen e fitimit të shoqërisë në kapitalin themeltar.

Në mbështetje të Vendimit për zmadhimin e kapitalit themeltar pagesat e në shoqëri mund të merren nga:
- themeluesi ekzistues i shoqërisë-----------------------------------------------------------------------
- persona të tjerë---------------------------------------------------------------------------------------

**Neni 19**

PRISHJA E SHOQËRISË:
ARSYET PËR PRISHJEN E SHOQËRISË JANË:--------------------------------------------------
1. Vendimi i ortakëve------------------------------------------------------------------------------------
2. Përthithja e shoqërisë me një shoqëri tjetër dhe bashkimi me një shoqëri tjetër--------------------
3. Vendim i formës së prerë të gjykatës, e cila refuzon hapjen e procesit të falimentit si pasojë e pamundësisë që nga falimenti të mbulohen shpenzimet e procesit të falimentit,---------------------
4. Me vendim të formës së prerë të gjykatës, e cila konstaton se regjistrimi i shoqërisë në regjistrin tregtar ka qenë i jashtëligjshëm,---------------------------------------------------------------
5. Me nisjen e procedurave të falimentit---------------------------------------------------------------
6. Me vendim të Gjykatës ku është regjistruar, i cili është dhënë në përputhje me Ligjin "Për shoqëritë tregtare",----------------------------------------------------------------------------------
7. Me heqjen e shoqërisë.------------------------------------------------------------------------------

**Neni 20**

PAJISJA ME PROKURË:
Shoqëria mund të ketë person të pajisur me prokurë. Vendimi për emërimin e personit merret nga ortakët e shoqërisë.-------------------------------------------------------------------------------

**Neni 21**

DEGA:
Shoqëria mund të kryejë aktivitetin e saj përmes degës. Vendimi për themelimin e degës merret nga Bordi Drejtues. -----------------------------------------------------------------------------

**Neni 22**

LIKUJDUESI:
Likuidimi kryhet nga Bordi Drejtues në rast se ortakët e shoqërisë nuk marrin vendim për emërimin e një ose më shumë personave si likujdues.--------------------------------------------

**Neni 23**

ZBATIMI I LIGJIT PËR SHOQËRITË TREGTARE:

Për marrëdhëniet të cilat nuk rregullohen përmes kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohet Ligji "Për shoqëritë tregtare" dhe ligje të tjera.----------------------------------------------------------------------------

Nr.:OU-4/16-1

**Neni 24**

HYRJA NË FUQI:
Kjo Marrëveshje e shoqërisë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga të gjithë ortakët e shoqërisë.----------------------------------------------------------------------------

**Neni 25**

Si shenjë për marrjen përsipër të të drejtave dhe detyrimeve nga kjo Marrëveshje e shoqërisë, ortakët e shoqërisë e firmosin atë.----------------------------------------------------------------------------

Solin, më 12.01.2016 (dymbëdhjetë janar i vitit dymijë e gjashtëmbëdhjetë)--------------------------
----------------------------------------------------------------------------

ORTAKËT E SHOQËRISË/THEMELUESIT

RADE PEHAR
(me nënshkrimin e tij)

______________________

DENIS RADIĆ-LIMA
(me nënshkrimin e tij)

______________________

IVICA BELIĆ
(me nënshkrimin e tij)

______________________

Iu lexova palëve këtë akt noterial dhe pasi i shtrova disa pyetje, u binda për vullnetin e tyre të lirë. Më pas palët firmosën me shkrimin e tyre secilën faqe të dokumentit burimor.-----------------
----------------------------------------------------------------------------

Tarifa noteriale është paguar në shumën 100, 00 kn, sipas numrit tarifor 11, paragrafi 7, të Ligjit "Për tarifat e shërbimeve noteriale".
Shërbimi i noterisë sipas nenit 13 të Rregullores për Tarifën e Përkohshme Noteriale, është llogaritur në shumën 200, 00 kn dhe mbi këtë shumë është shtuar dhe TVSH-ja (25%) që llogaritet në shumën e 50,00 kn. Totali është 350,00 kn.

NOTERI PUBLIK
BOŠKO JURIŠIĆ
vendi i vulës — me nënshkrimin e tij

***DOKUMENTI PËRFUNDIMTAR I SHKRUAR***

Unë, NOTERI PUBLIK, Boško Jurišić, NID: 0508948380017, me seli në Solin, K.Zvonimira 85, vërtetoj që :

E kam krahasur këtë dokument përfundimtar me dokumentin burimor, i cili ndodhet në arkivën time dhe kam vërtetuar që përputhet plotësisht me dokumentin burimor.
Ky I dokument përfundimtar është i zakonshëm-i njehsuar-i plotë në ekstrakt dhe i janë bashkëlidhur _/__ dokumente si shtojcë e aktit noterial.
Ky dokument është hartuar për GJYKATËN TREGTARE NË SPLIT, për arsye /___, nëse lëshohet sërish.
Noteri publik dhe palët kanë vendosur inicialet e tyre në çdo faqe dhe kanë firmosur faqen e fundit të dokumentit burimor, të cilin noteri publik e ka njehsuar duke vendosur vulën e tij.

Nga pikëpamja juridike dokumenti përfundimtar i shkruar zëvendëson plotësisht dokumentin burimor.

Tarifa noteriale është paguar sipas numrit tarifor 12 të tarifave noteriale në shumën ____/____, është ngjitur, anulluar në kopjen që lihet në arkivën e zyrës noteriale.
Lirohet nga pagimi i tarifave noteriale bazuar në nenin _______/_______të Ligjit "Për noterinë".

Shërbimi noterial për njehsimin është llogaritur në shumën ___/___kn, TVSH (25%) ____/____, shpenzimi_____/____kn.
Totali:______/_______kn.
(R-1)
Numër: OU-4/16-1
Solin, më 12.01.2016

NOTERI PUBLIK
Boško Jurišić

vulë e noterit

vulë e Gjykatës Tregtare në Split

REPUBLIKA E KROACISË
GJYKATA TREGTARE NË SPLIT R3-2498/21
Kjo kopje-shkresë është identike me dokumentin burimor-dokumentin që ruhet në arkivën e regjistrit gjyqësor.
Tarifa gjyqësore është paguar në shumën 65,00 kn sipas numrit tarifor nr.28 dhe 39 të Ligjit "Mbi tarifat gjyqësore" (Fletorja Zyrtare 74/95, 57/96 dhe 137/02)
Split, më 19.07.2021

Nëpunësi i autorizuar
firmë

Sh.përkthyesi:
Çdo faqe e dokumentit është vulosur me vulën e Gjykatës Split.

**APOSTILLLE**

**(CONVENTION DE LA HAYE DU 5 OCTOBRE 1961)**

1. Shteti : REPUBLIKA E KROACISË

Ky dokument publik

2. firmosur nga Ana Ivandić
3. në cilësinë e Nëpunësi i autorizuar
4. është pajisur me të drejtë vule (steme) nga Republika e Kroacisë, Gjykata Tregtare në Split, Split

Vërtetuar

5. në Split 6. më datë 26.08.2021
7. emri i organit kompetent: GJYKATA E RRETHIT SPLIT
8. nën nr. Ov-I-748/2021-4
9. vula: 10. firma

Kryetare e gjykatës

2 vula të Gjykatës së Rrethit Split Marina Boka

firmë

Përktheu:

Albana SHEHU

SLUŽBENI PREVODITELJ ZA HRVATSKI JEZIK
Përkthyese Zyrtare për Gjuhën KROATE
ALBANA SHEHU

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER ENINA B. JUNIKU**

V2021052490003523608

PULLË TARIFE 200 LEKË R.SHQIPËRISË

**DATE 17/09/2021**
**NR REP 106**

## VËRTETIM I NËNSHKRIMIT
**(Në përkthimin zyrtar të dokumentit)**

Në Tiranë, sot më datën 17 (shtatëmbëdhjetë) Shtator 2021 (dy mijë e njëzet e një), ditën e premte, përpara meje Noter **Enina B. JUNIKU**, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me seli në adresën: Bashkia Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, rruga "Perlat Rexhepi", Nd. 1, H. 14, kati i II-të, Zyra Nr. 2, Tiranë, u paraqit personalisht :

**Person Fizik "ALBANA SHEHU"**, i regjistruar si subjekt tregtar më datën 16.01.2020, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, filiali Tiranë dhe e pajisur nga kjo zyrë me Çertifikatë Regjistrimi, Person i Tatueshëm, me numër identifikimi (NUIS) M01316006N, me status Aktiv, me seli në adresën: Njësia Administrative Nr.1, rruga "Ali Demi', pallati Gener 2, hyrja nr.1, ap.23, përfaqësuar nga **Znj. Albana SHEHU**, atësia Pëllumb, amësia Diana, datëlindja 28.06.1986, vendlindja Memaliaj, Tepelenë, shtetase shqiptare, banuese në adresën e vet deklaruar: Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Nr. 1, 1004, rruga "Idriz Dollaku" Nd. 2, H. 12, Ap. 21, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar nëpërmjet dokumentit Letëmjoftim me numër 035511654 dhe numër personal I65628046F, me datë lëshimi 07.01.2020, autoritet lëshues MPB, e njohur personalisht prej meje noteres, si Përkthyese Zyrtare e Gjuhës Kroate, e autorizuar për përkthim zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu sa më sipër dokumentin e huaj ***"Dokumenti Përfundimtar i shkruar Nr.OU-4/16-1, i Tekstit të plotë të Marrëveshjes së Shoqërisë për Themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar "ALFA ATEST" d.o.o. (SHPK) për mbrojtjen në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen e mjedisit" lëshuar nga Noteri Publik Boško Jurišč, Solin, Kralja Zvonimira 85, Republika e Kroate, noterizuar me Nr.OU-4/16-1, datë 12.01.2016, legalizuar nënshkimi i noterit me Vulë Apostille Ov-I-748/2021-4, datë 26.08.2021, të Gjykatës së Rrethit Split, Kroaci" nga gjuha e burimit "KROATE" në gjuhën e synuar "SHQIPE"***, *njësoj me origjinalin dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje*. Dokumenti original në guhën e burimit Kroate që përkthehet përbëhet gjithësej nga 10 (dhjetë) fletë. Dokumenti origjiarai i përkthyer në gjuhën e synuar Shqipe, nga përktyesi dhe i nënshkruar prej saj, përbëhet gjithësej nga 11 (njëmbëdhjetë) fletë.

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij vërtetimi të nënshkrimit të përkthimit, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, përpunim dhe deklarim i cili i bëhet i ditur nga unë noterja dhe miratohet nga vetë kërkuesja e shërbimit noterial.

Për sa më sipër, përpilohet nga unë noterja ky vërtetim i nënshkrimit të përkthyeses zyrtare të autorizuar për përkthim zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, bazuar në nenin 62 gërma "j" dhe nenin 135 e vijues, të Ligjit Nr.110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë" dhe unë noterja e vërtetoj nënshkrimin e saj, konform ligjit të Republikës së Shqipërisë.

| | |
|---|---|
| **Përkthyesi nënshkrues** | **N O T E R** |
| **Albana SHEHU** | **ENINA B. JUNIKU** |